EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6283
E martë, 6 prill 2021
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Osmani është presidente e Kurtit

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA E KOSOVËS KA MIRATUAR MASAT E REJA KUNDËR COVIDIT FAQE 4-5

KUFIZOHET SHËRBIMI I GASTRONOMISË DHE LËVIZJA E QYTETARËVE

Qeveria e Kosovës ka miratuar të hënën masat e reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Masat e reja parashohin mbylljen lokaleve të gastronomisë dhe kufizimin e qarkullimit të qytetarëve deri më 18 prill. Sipas vendimit të qeverisë, qarkullimi i qytetarëve do të ndalohet nga ora 22:00 deri në orën 5:00, përveç në raste urgjente. Ndërsa shërbimet e gastronomisë obligohen ta pezullojnë aktivitetin e tyre nga data 6 prill deri më 18 prill. Gjithashtu, masat ndalojnë organizmin e ahengjeve me më shumë se dhjetë persona

AKTUALE

INICIOHET SHKARKIMI I MINISTRIT MALAZEZ PËR SHKAK TË DEKLARATËS PËR SREBRENICËN F. 2

EDHE NJËMBËDHJETË TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË F. 3

PËRUROHET OBJEKTI I RI I URGJENCËS NË DEÇAN F. 6

EKONOMI

PAS MBYLLJES DYJAVORE, BIZNESET ËSHTË DASHUR TË PËRKRAHEN FINANCIARISHT F. 9

NJË MUAJ PARABURGIM NDAJ TRE PERSONAVE QË DYSHOHEN PËR FALSIFIKIM TË PARAVE F. 9

SPORT

PËRBALLJE INTERESANTE NË ÇEREKFINALE TË LIGËS UNIKE F. 12

NË 22-VJETORIN E MASAKRËS SË REZALLËS KËRKOHET DREJTËSI PËR TË RËNËT DHE TË ZHDUKURIT FAQE 8



KDI-ja VIZITON KOMUNAT KU JANË ZBATUAR PROJEKTET E FINANCUARA NGA BE-ja FAQE 3

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Iniciohet shkarkimi i ministrit malazez për shkak të deklaratës për Srebrenicën

PODGORICË, 5 PRILL - Kryeministri i Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq, propozoi shkarkimin e ministrit të Drejtësisë në këtë vend, Vlladimir Leposaviq, për shkak të qëndrimit të tij ndaj gjenocidit në Srebrenicë.

Në një konferencë të jashtëzakonshme për gazetarë, Krivokapiq ka thënë se e ka dërguar këtë propozim në Parlamentin e Malit të Zi.

Në një seancë parlamentare më 26 mars, Leposaviq ka thënë se është i gatshëm të pranojë se në Srebrenicë ka ndodhur gjenocid "kur një gjë e tillë të vërtetohet pa dyshime". Me këtë deklaratë, ai ka sfiduar edhe legjitimitetin e Gjykatës së Hagës për ish-Jugosllavinë e cila ka konstatuar se në Srebrenicë ka ndodhur gjenocid. "Pas deklaratës së diskutueshme i kam dërguar një mesazh që ai duhet të nxirret vetë nga ajo që ka gatuar vetë. Kam menduar se deklarata e tij do të ishte e atillë që të amortizonte atë që është thënë, por ajo ka mbetur me prapavijën e njëjtë", ka deklaruar Krivokapiq, duke aluduar në deklaratën e dytë të Leposaviqit që ka bërë tre ditë më vonë, duke shprehur të njëjtat pikëpamje.

Deklarata e Leposaviqit ka nxitur reagime të shumta nga publiku vendas dhe ndërkombëtar, që ka kërkuar dorëheqjen e tij. Po ashtu, ka pasur thirrje për reagim të prokurorisë.

Kryeministri Krivokapiq ka pohuar se detyrim i Leposaviqit ka qenë që t'i përgjigjej pyetjes parlamentare rreth Srebrenicës në frymën e politikës së qeverisë, e jo në frymën e debatit akademik. "I kam kërkuar dorëheqjen sepse është më mirë që me një akt personal të tregojmë përgjegjësi. Këtë e kam bërë të premten edhe sot. Meqenëse Leposaviq ka mbajtur pozicionin e tij, unë kam propozuar shkarkimin e një anëtari të qeverisë, në këtë rast të ministrit Leposaviq", ka thënë Krivokapiq, për të shtuar se është e papranueshme që ministri i Drejtësisë t'i shprehë pikëpamjet e tij private.

Edhe Bashkimi Evropian ka bërë thirrje që të mos relativizohet apo mohohet gjenocidi në Srebrenicë, duke thënë se zyrtarët në të gjitha shtetet që synojnë integrimin në BE, duhet të jenë të gatshëm t'i respektojnë vlerat evropiane, ndër të cilat është edhe trajtimi me respekt i viktimave të gjenocidit dhe krimeve të luftës.

Secilit në Britani do t'i ofrohen dy teste të shpejta për koronavirus brenda javës



Londër, 5 prill - Nga e premtja secili person në Britani të Madhe do të ketë qasje në dy teste të shpejta për koronavirus në javë. Testet, rezultatet e të cilave dihen brenda 30 minutave, do të jenë të qasshme falas në qendra të testimit, barnatore apo mund të dërgohen me postë. Ministria britanike e Shëndetësisë ka thënë se me këtë hap synon t'i shmangë shpërthimet e koronavirusit teksa lehtësohen masat e izolimit.

Mirëpo kritikët kanë thënë se ky program rrezikon të kthehet në shpenzim "skandaloz" të parave. Kryeministri britanik Boris Johnson pritet të takohet të hënën me kabinetin qeveritar për ta nënshkruar fazën e re të lehtësimit të masave, çka mund të mundësojë hapjen e dyqaneve jo të domosdoshme dhe rihapjen e restoranteve nga 12 prilli. Testet e shpejta veçse kanë nisur t'iu ofrohen fëmijëve nëpër shkolla dhe familjeve të tyre, si dhe atyre që nuk mund të punojnë nga shtëpitë. Ky lloj i testit, që mund të kryhet në shtëpi, ka për qëllim testimin e personave që nuk kanë simptoma të koronavirusit.

Franca po heton ministrat që akuzohen se kanë darkuar në restorante sekrete

PARIS, 5 PRILL - Autoritetet franceze janë duke hetuar akuzat se ministra qeveritarë dhe zyrtarë të tjerë kanë darkuar nëpër restorante sekrete, në kundërshtim me kufizimet për luftim të koronavirusit.

Zyra e Prokurorit të Parisit ka thënë se hetimet kanë nisur të dielën për akuza të mundshme të rrezikimit dhe punës së padeklaruar, si dhe për identifikim të organizatorëve dhe pjesëmarrësve në organizimet e supozuara.

Në një dokumentar të transmetuar në rrjetin francez M6 në fundjavë, është përfshirë edhe një burrë i paidentifikuar duke thënë se ka ngrënë në dy apo tre restorante "me një numër të ministrave".

Anëtarët qeveritarë kanë mohuar se janë të dijeni të këtyre organizimeve.

Ministri i Brendshëm në Francë, Gerald Darmanin, i ka kërkuar policisë që t'i hetojë pretendimet.

Zyra e Prokurorit ka thënë të hënë se hetimet janë duke vazhduar, pavarësisht prej raportimeve se burri që ka folur në dokumentar, ka tërhequr deklaratat e tij.

Restorantet franceze janë mbyllur në muajin tetor me qëllim të ngadalësimit të përhapjes së koronavirusit.

Franca së fundmi ka miratuar një masë për izolim të pjesshëm, pas rritjes së numrit të pacientëve të infektuar me koronavirus, të cilët kanë kërkuar ndihmë nëpër spitale.

Zëdhënësi qeveritar Gabriel Attal ka thënë për televizionin LCI se autoritetet janë duke

hetuar raportimet për festa nëpër restorante dhe 200 persona të dyshuar që janë identifikuar përballen me "ndëshkime të ashpra".

Ministrat qeveritarë "e kanë për detyrë që të jenë shembull", ka thënë mes të tjerash Attal.

Turqia arreston 10 admiralë në pension, nën dyshimet për komplot për puç

ANKARA, 5 PRILL - Turqia ka arrestuar dhjetë admiralë të pensionuar, të cilët kanë nënshkruar një letër të hapur, duke pohuar rëndësinë e Konventës Montre për sigurinë turke. Kjo konventë është krijuar për ta parandaluar militarizimin e Detit të Zi.

Letra e hapur, e nënshkruar nga 104 ish-pjesëtarë të rangut të lartë të marinës, është dënuar nga zyrtarët turq, të cilët e shohin si sfidim të drejtpërdrejtë të qeverisë nga ana e ushtrisë.

Zëdhënësi presidencial, Ibrahim Kalin, ka pohuar se letra përmban shenjat dalluese të një komploti ushtarak për ta përmbysur qeverinë. "Disa ushtarë në pension po e vendosin veten në një pozitë qesharake dhe të mjerueshme me deklaratën e tyre, e cila i bën jehonë kohës së puçit ushtarak", ka deklaruar Kalin.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Edhe njëmbëdhjetë të vdekur nga Covidi në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fubndit janë konfimruar edhe 11 njëmbëdhjetë viktima nga Covid-19. Po ashtu janë konfirmuar edhe 512 raste të reja me ketë virus. Numri i rasteve aktive me Covid në Kosovë është 14 284

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 PRILL- Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR, si dhe laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 4 718 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 512 raste pozitive.

Brenda 24 orëve janë raportuar edhe njëmbëdhjetë raste të vdekjes si pasojë e virusit Covid. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Mitrovicë dy raste (71, 68 vjeç), Prishtinë dy raste (79, 76 vjeç), Ferizaj një rast (76 vjeç), Gjakovë një rast (78 vjeç), Kamenicë një rast (54 vjeç), Obiliq një rast (79 vjeç), Prizren një rast (77 vjeç), Viti një rast (58 vjeç) dhe Vushtrri një rast (79 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 94 167 raste nga 447 840 persona të dyshimtë me ketë virus dhe 1 926 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 524 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 77 957 raste, kurse numri i rasteve aktive është 14 284.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 185 raste, Gjakovë 39 raste, Ferizaj 37 raste, Gjilan 37 raste, Pejë 37 raste, Mitrovicë 25 raste, Podujevë 22 raste, Fushë-Kosovë 21 raste, Kamenicë 13 raste, Kaçanik 12 raste, Prizren 9 raste, Vushtrri 9 raste, Obiliq 8 raste, Skenderaj 8 raste, Drenas 7 raste, Malishevë 7 raste, Lipjan 6 raste, Viti 6 raste, Klinë 5 raste, Suharekë 5 raste, Rahovec 4 raste, Shtime 4 raste, Deçan 2 raste, Istog 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash dhe Graçanicë.

KDI-ja viziton komunat ku janë zbatuar projektet e financuara nga BE-ja

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Javën e kaluar Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar një vizitë ditore nëpër disa lokalitete në Lipjan dhe Mitrovicë me përfaqësues të shoqërisë civile dhe studentë.

Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte që të vizitohen projekte që janë mbështetur financiarisht nga BE-ja në komunat e Kosovës e që kanë ndihmuar drejtpërdrejt në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Sipas një njoftimi të KDI-së, kjo vizitë ka shërbyer si një mundësi e mirë për pjesëmarrësit që të marrin një pasqyrë të investimeve lokale të BE-së dhe përdorimin e fondeve publike, por edhe si një forum për t'u takuar me përfaqësuesit dhe vendimmarrësit nga komunat përkatëse. "Me një grup prej 25 pjesëmarrësish vizituam fillimisht Bibliotekën dhe Arkivin në Komunën e Lipjanit, ku u pritën nga udhëheqësi i Qendrës Kulturore, Selman Jashanica, dhe udhëheqësi i sektorit për Arkiva, Enver Haziri. Të dy përfaqësuesit e komunës prezantuan para pjesëmarrësve këto dy projekte që janë financuar nga institucionet BE-së, procesin e ndërtimit, kushtet që ofrojnë këto objekte dhe përfitimet që ka pasur komuna dhe qytetarët e Lipjanit nga ndërtimi i tyre. Ndërkaq, pjesëmarrësit kërkuan të dinë më shumë rreth interesimit të nxënësve dhe studentëve për t'i shfrytëzuar shërbimet që i ofron biblioteka e re dhe kapacitetet që ajo ka për t'i plotësuar kërkesat, për çka morën përgjigje nga përfaqësuesit në fjalë", është bërë me dije në njoftimin e KDI-së. Një vizitë e së njëjtës natyrë u zhvillua edhe në Komunën e Mitrovicës, gjegjësisht në katër lokacione të ndryshme, projekte të ndërtuara me përkrahje financiare nga BE-ja. Projektet si Ura e Ibrit, shëtitorja e lumit Ibër dhe sheshi i qytetit u prezantuan nga udhëheqësi i Departamentit të Infrastrukturës, Fisnik Ibrahimi, dhe ai i Departamentit të Urbanizmit, Florent Abrashi nga Komuna e Mitrovicës.

Ata dhanë edhe sqarime për pjesëmarrësit për koston, historikun dhe përfitimet nga këto investime. "Ndërkaq në N. P. 'Qendra Multifunksionale Omni Sport', që ishte edhe projekti i katërt që u vizitua, kryeshefi ekzekutiv i N. P. 'Qendra Multifunksional Omni Sport', Sami Zeka, ka informuar pjesëmarrësit me shërbimet që i ofron kjo qendër për qytetarët, sidomos nxënësve për zhvillimin e kurseve për shumë lloje të sporteve. Ndër të tjera, ai tregoi për interesimin e madh të qytetarëve nga të gjitha komunat e Kosovës për t'i shfrytëzuar hapësirat dhe shërbimet që i ofron kjo qendër, si një nga qendrat më të mëdha në Kosovë të këtij lloji. Ai, po ashtu, përmendi edhe sfidat me të cilat përballen si ndërmarrje, që është kostoja financiare që nevojitet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e duhur të saj", është theksuar në njoftimin e KDI-së.

QEVERIA E KOSOVËS KA MIRATUAR MASAT E REJA KUNDËR COVIDIT

Kufizohet shërbimi i gastronomisë dhe lëvizja e qytetarëve

Qeveria e Kosovës ka miratuar të hënën masat e reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Masat e reja parashohin mbylljen lokaleve të gastronomisë dhe kufizimin e qarkullimit të qytetarëve deri më 18 prill. Sipas vendimit të qeverisë, qarkullimi i qytetarëve do të ndalohet nga ora 22:00 deri në orën 5:00, përveç në raste urgjente. Ndërsa shërbimet e gastronomisë obligohen ta pezullojnë aktivitetin e tyre nga data 6 prill deri më 18 prill. Gjithashtu, masat ndalojnë organizmin e ahengjeve me më shumë se dhjetë persona

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 PRILL - Qeveria e Kosovës ka miratuar të hënën masat e reja kundër Covidit të cilat do të jenë në fuqi deri më 18 prill. Me masat e reja ndalohet qarkullimi i qytetarëve nga ora 22:00 deri në 5:00, përveç në rastet emergjente.

Shërbimet e gastronomisë obligohen ta pezullojnë aktivitetin e tyre nga data 6 prill deri më 18 prill. Sipas vendimit të qeverisë, gastronomia lejohet të punojë vetëm me shërbimet "merr me vete", "dërgesë me porosi" apo marrjes së porosive pa u larguar nga makinat.

Vendimi i qeverisë ndalon veprimtaritë e qendrave të mbyllura tregtare, përveç shërbimeve esenciale në kuadër të tyre, siç janë dyqanet ushqimore dhe farmacitë, nga data 7 prill deri më 18 prill. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (nga data 12 prill deri më 18 prill), dhe të gjitha institucionet publike dhe private universitare nga data (7 prill deri më 18 prill) obligohen që t'i organizojnë online të gjitha aktivitetet mësimore. Po ashtu, ndalohet organizimi i ahengjeve me më shumë se dhjetë persona.

"Ndalohen të gjitha grumbullimet me rrezikshmëri të lartë të shpërndarjes së infeksionit me më shumë se dhjetë persona (mbledhjet, seminaret, trajnimet, dasmat, ahengjet familjare, homazhe e të ngjashme). Përjashtimisht mbajtja e pamjes ndalohet", është thënë në pikën 21 të vendimit të Qeverisë së Kosovës. Në vendim thuhet se institucionet publike dhe private obligohen që të paraqitet në punë vetëm stafi i cili kryen shërbime esenciale.

Për qytetarët e huaj që hyjnë në Kosovë, përfshirë edhe ata me leje qëndrimi të përkohshëm ose të përhershëm në Kosovë, që vijnë nga vendet me rrezik të lartë, sipas listës zyrtare të Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), duhet të kenë test RT-PCR negativ për Covid-19 të bërë në 72 orët e fundit, në bazë të parimit të reciprocitetit, në të kundërtën duhet të vetizolohen për shtatë ditë.

Në arsyetimin e Qeverisë së Kosovës për masat e reja është thënë se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ië Kosovës (IKShPK) ka testuar 147 mostra pozitive me koronavirus për detektimin të variantit britanik të koronavirusit dhe atij të Afrikës Jugore.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka deklaruar se këto mostra ishin pranuar nga të gjitha rajonet e Kosovës dhe të cilat kishin rezultuar pozitive në SARS-CoV-2 gjatë ditëve të fundit. Nga numri total i mostrave të testuara, 97.27 për qind e tyre ishin me variantin britanik dhe asnjë me variantin e Afrikës së Jugut. Prandaj, sipas tij, kjo situatë, ku varianti britanik është më së shumti i përhapur, kërkon që të minimizohet sa më shumë ekspozimi ndaj Covid-19 dhe të ngadalësohet përhapja e tij në mënyrë që kapacitetet e shërbimit spitalor të jenë të përballueshme dhe të menaxhueshme.

Qeveria po bën përpjekje për ta siguruar vaksinën

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka theksuar se Kosova po përballet me një situatë të rënduar me Covid-19 dhe masat e reja janë të domosdoshme. Në një konferencë për media, ai ka thënë se qeveria po bën përpjekje për ta siguruar vaksinën. "Trendi është shumë i keq, 16.7 për qind. Të keni parasysh që prej afër gjysmë milioni testeve që janë bërë ka dalë më shumë se çdo i pesti është pozitiv kur është testuar. Në njërën anë po përpiqemi për vaksina sa më shumë, në

→

anën tjetër maska, higjiena, distanca ajrosja janë të domosdoshme", ka thënë Kurti.
Ai ka thënë se situata me furnizim me vaksina në Kosovë është delikate. "Në parim duhet ta kemi parasysh që Kosova nuk njihet nga disa shtete, sidomos nga dy fuqi të mëdha. Orientimi ynë është evropian dhe euroatlantik, prandaj e kemi skeptizmin dhe qëndrimin tonë karshi ndihmave të shteteve që nuk na njohin. Në këtë situatë, gjendja është më delikate", ka thënë Kurti
Kurse ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se janë duke negociuar me kompanitë prodhuese për blerjen e vaksinave, por për shkak të konfidencialitetit, derisa të nënshkruhet kontrata, nuk do t'i bëjnë publike detajet e tjera. Ai ka deklaruar se janë duke pritur ardhjen e 76 mijë vaksinave nga programi COVAX, gjithashtu edhe ndihmat nga Komisioni Evropian.
Vitia ka treguar se kanë marrë konfirmim edhe nga disa kompani të tjera për sjelljen e vaksinave në Kosovë, por derisa të nënshkruhet kontrata nuk mund të bëhet me dije. "Natyrisht se nuk presim vetëm nga donacionet. Janë rreth 50 milionë euro të siguruara nga Qeveria e Kosovës për blerjen e këtyre vaksinave. Është një proces i negocimit shumë serioz për sigurimin e këtyre vaksinave me kompanitë prodhuese", ka deklaruar Vitia.

Gastronomët respektojnë vendimin e qeverisë

Pas vendimit të qeverisë, kryetari i Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës, Petrit Kllokoqi, nuk është pajtuar me masat e reja, por ka thënë se do t'i respektojmë ato. "Edhe një herë: Politika shkakton dëm, gastronomia paguan faturën. Edhe një herë gastronomia kurban i situatës. Edhe një herë po ndëshkohemi, 11 ditë. Pas 11 ditësh ne do të hapemi. Me ose pa leje të qeverisë ne do të hapemi. Për këto 11 ditë do të kërkojmë subvencionime të pagave, të qirave dhe grande për biznese. Do të kërkojmë strategji për të ardhëm tonë!", ka shkruar ai në profilin e vet në "Facebook".
Ai ka treguar se gjatë kohës së mbylljes do t'i vazhdojnë bisedimet me qeverinë për të gjetur ndonjë marrëveshje. "Më mirë është të funksionojë gastronomia e të qarkullojë paraja, e me këto para të investohet në shëndetësi, të sigurohen shtretër e hapësira të mjaftueshme për të gjithë të prekurit me Covid si rezultat i fushatave parazgjedhore, e të sigurohen vaksina, se të sanksionohen bizneset. Ne për këto 11 ditë mbyllje do t'i vazhdojmë bisedimet me Qeverinë e Kosovës me shpresë që të arrijmë një marrëveshje, mirëpo nëse nuk arrijmë një marrëveshje, pas 11 ditësh nuk përjashtojmë daljen në rrugë.

Shtyhet vaksinimi i mësimdhënësve të Kosovës në Shqipëri

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se procesi i vaksinimit të mësimdhënësve kosovarë në Shqipëri është shtyrë pasi nuk ka më sasi të vaksinave "AstraZeneca" dhe "Pfizer" atje. Vitia ka thënë se ka pasur kontakte të vazhdueshme me homologen Orgeta Manastirliu, e cila i ka premtuar që sapo të vijnë doza të tjera të këtyre dy llojeve të vaksinave, atëherë një sasi e caktuar do t'i ruhet Kosovës për vaksinimin e mësimdhënësve. "Dozat e vaksinave "AstraZeneca" dhe "Pfizer" janë harxhuar, siç më ka njoftuar ministrja Manastirliu. Në Shqipëri po vazhdon vaksinimi me "Sinovax", e cila është prodhuar nga Kina dhe për arsye se në Kosovë na ndalojnë ligjet që të importojmë produkte që nuk janë të regjistruar në EMA (Rregullatori Evropian i Barnave), ne nuk e kemi parë të arsyeshme që mësimdhënësit të vaksinohen. Kjo është arsyeja pse është shtyrë procesi. Manastirliu më ka thënë se sapo të vijnë doza të tjera të dy llojeve të vaksinës, atëherë do ta ndihmojnë Kosovën", ka thënë Vitia.

Vrasja e Kujtim Veselit: KPK nuk ofron qasje në dosjen hetimore ndaj prokurorit

Prishtinë, 5 prill - Më 20 tetor 2020 Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi me 25 vjet burgim Sefedin Osmanin, i cili akuzohej për dhunim të përsëritur dhe vrasjen e 11-vjeçarit nga komuniteti ashkali, Kujtim Veseli nga Fushë-Kosova. Për këtë rast, familja, avokatja dhe shoqëria civile kërkuan hetim penal ndaj zyrtarëve policorë si dhe prokurorëve të cilët, sipas tyre, por edhe sipas një raporti të Avokatit të Popullit, neglizhuan rrezikun me të cilin ishte duke u përballur Kujtimi. Pavarësisht prej kërkesave, zyrtarët policorë shpëtuan pa u ndjekur penalisht, njëjtë siç kaloi edhe prokurori i rastit, Ruhan Salihu.
Pas një hetimi që u krye ndaj tij, më 12 nëntor 2019 Këshilli Prokurorial i Kosovës konstatoi se prokurori Ruhan Salihu, kishte kryer shkelje disiplinore përmes veprimeve të tij në rastin vrasjes së Kujtim Veselit. "Zvogëlim i përkohshëm i pagës në 30 për qind për një periudhë kohore 6 muaj", thuhej në vendimin e Këshillit Prokurorial për këtë rast.
Por që nga kjo kohë Këshilli Prokurorial i Kosovës është duke refuzuar që të ofrojë qasje në dosjen e panelit hetimor i cili vendosi këtë masë disiplinore për prokurorin Salihu.
Skord Retkoceri, aktivist i shoqërisë civile, përmes shkresave që i ka REL-i, ka kërkuar që të ketë qasje në dosjen e panelit hetimor, por KPK-ja ka refuzuar që ta mundësojë një gjë të tillë, ndonëse kjo çështje nuk është qartësisht e rregulluar me ligj.
Retkoceri thotë se refuzimi i KPK-së për të ofruar qasje në raportin e panelit hetimor i bënë ata të dyshojnë "që ka të dhëna të cilat KPK nuk dëshiron të bëhen publike, të dhëna të cilat do të mund të sjellin në pah parregullsi të tjera në procesin hetimor".
Një prej arsyetimeve të KPK-së për moslejim të qasjes në raportin e panelit hetimor është fakti se aty ka të dhëna personale, por ky, sipas Retkocerit, nuk është argument i mjaftueshëm. "Ne në këtë rast jemi më shumë të interesuar ta dimë arsyetimin konkret për shqiptimin e sanksionit disiplinor aq të ulët, prandaj do të ishim të gatshëm që ta pranonim nga KPK vendimin dhe raportin hetimor ku të dhënat e dëshmitarëve janë të redaktuara", thotë Ratkoceri.

Avokati i Popullit përmes një shkrese më 3 mars 2021 i rekomandoi KPK-së që t'i ofrojë Skord Retkocerit qasje në dokumentet e kërkuara. Në përgjigjen e KPK-së në shkresën e Avokatit të Popullit thuhet se "raporti i panelit hetimor nuk mund të bëhet publik sepse nuk e lejon ligji".
KPK-ja citon nenin 41 të Kushtetutës, paragrafin 2, i cili thotë se "dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë".
Refuzimin për të ofruar qasje në raportin e panelit hetimor, KPK-ja e arsyeton edhe me Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve.
Avokatja që përfaqëson pranë gjykatës rastin e Kujtim Veselit, Rina Kika, thotë se KPK-ja është duke vepruar jashtëligjshëm kur po pamundëson qasjen në dokumentet e panelit hetimor.

KFOR-i dhuron dhjetë pajisje oksigjeni në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Dragash

DRAGASH, 5 PRILL (ER) - Drejtor i Shëndetësisë në Dragash, Behar Brenolli, ka theksuar se nevoja për këto pajisje u rrit pas fillimit të pandemisë Covid-19. Ndërkaq drejtori i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Dragash, Ramadan Jashari, ka thënë se ky është një donacion shumë i rëndësishëm në një periudhë kur numri i pacientëve po rritet. "Ne kemi qenë në shërbim të qytetarëve me stafin që nga fillimi i Covid-19 dhe kemi arritur ta mbajmë situatën nën kontroll dhe komuna jonë kurrë nuk ka qenë në zonën e kuqe deri më tani. Deri më tani në komunën tonë ishin zyrtarisht pozitivë me virusin Korona 383 qytetarë, nga të cilët, për fat të keq, betejën me Covid-19 e humbën 39 prej tyre", ka thënë ai.

Përfaqësuesi i KFOR-it italian ka theksuar se sot ata janë me fat që mund të ndihmojnë qytetarët me aktivitetet e tyre dhe se do të vazhdojnë të ofrojnë ndihmë për popullatën e kësaj komune përmes aktiviteteve të ndryshme.

Ismajli kërkon nga organet e drejtësisë zbardhjen e masakrës së Llovcës

GJILAN, 5 PRILL (ER) - Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe te varrezat e shtatë martirëve të fshatit Llovcë, të ekzekutuar nga forcat paramilitare serbe 22 vjet më parë. Në emër të kryetarit Haziri, Ismajli ka kërkuar zbardhjen e kësaj masakre makabre në mënyrë që eshtrat e tyre pushojnë të qetë. "Shtatë martirët e Llovcës u sakrifikuan për lirinë, pavarësinë dhe të drejtat e shqiptarëve. Ky është një përvjetor i dhimbjes, por në të njëjtën kohë edhe i krenarisë sepse falë tyre ne po e gëzojmë këtë ditë të bardhë. Kaluan 22 vjet dhe akoma kjo masakër makabre mbetet e pazbardhur. Kërkojmë nga organet e drejtësisë që ta zbardhin sa më parë dhe autorët ta marrin dënimin meritor. Në këtë mënyrë eshtrat e tyre do të pushojnë të qetë. Lavdi e përjetshme!", ka thënë Ismajli, duke shtuar se Komuna e Gjilanit po i përkujton edhe masakrat e tjera, siç është ajo e Llashticës, e Zhegrës, e Lladovës e vendbanimeve të tjera, ku qytetarët e pafajshëm e kanë paguar në mënyrën më të ashpër dhe me sakrificën më të madhe sublime lirinë e Kosovës. Në emër të familjeve të martirëve ka folur djali i mësuesit Rahim Ymeri, Fitimi, i cili e ka falënderuar kryetarin Komunën e Gjilanit për nderimet që u ka bërë shtatë martirëve në 22-vjetorin e masakrës.

22 vjet më parë në fshatin Llovcë u masakruan në mënyrën më barbare shtatë persona: Rahim Ymeri (arsimtar), Xhemail Halimi, Xhevrije Zeqiri, Nexhmije Azemi, Rabit Dalipi, Sami Xhelili dhe Avdi Rexhepi.

Bahtiri inspekton punimet në infrastrukturën rrugore në Zhabar dhe Vërnicë

MITROVICË, 5 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga nënkryetari Faruk Mujka, dhe drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, kanë inspektuar disa nga punimet e kryera në rregullimin e infrastrukturës rrugore. Me këtë rast ata kanë parë për së afërmi punët e kryera në asfaltimin dhe kubëzimin e rrugëve dhe rregullimin e kanalizimeve në Zhabar dhe Vërnicë, respektivisht në rrugët "Pranvera", "Halit Ahmeti", "Rifat Osmani", "Zeqir Rexhepi" dhe "Safet Rexhepi".

Bahtiri ka theksuar se Komuna e Mitrovicës po bën përpjekje që konform buxhetit që ka të investojë aty ku është mëse e domosdoshme të intervenohet, në të mirë të mirëqenies dhe lehtësimit të jetës së qytetarëve. Ndërsa drejtori Naser Muja ka potencuar se Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë ka një sërë projektesh të tjera që do të realizohen në vazhdimësi, e që do të ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Përurohet objekti i ri i urgjencës në Deçan

Deçan, 5 prill (ER) - Të hënën në Komunën e Deçanit është bërë përurimi i objektit të ri të urgjencës. Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se kjo u bë falë punës dhe përkushtimit të ish-kryeministrit Ramush Haradinaj. "Sot Deçani u bë edhe me objektin e ri të urgjencës. Investimet për kompletimin e infrastrukturës shëndetësore në komunën tonë janë prioritet i yni. Mirënjohës dhe falënderues gjithmonë për ish-kryeministrin z. Ramush Haradinaj", ka shkruar Bashkim Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Lipjanit viziton atelienë ku po punohet shtatorja e dëshmorit Haradin Bajrami

LIPJAN, 5 PRILL (ER) - Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me familjen e dëshmorit Haradin Bajrami, kanë vizituar atelienë ku po punohet shtatorja e dëshmorit Haradin Bajrami. Kryetari Imri Ahmeti ka falënderuar skulptorin Agon Qosa për mjeshtërinë e tij profesionale që ka treguar në punimet e kësaj vepre madhështore.

Eshtrat që u zhvarrosën në Kishevak u përkasin viktimave të luftës në Kosovë

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ka pranuar informacione se eshtrat e zhvarrosura vitin e kaluar nga një varrezë masive në Kizhevak të Serbisë, e që më pas janë dërguar për analizë të ADN-së, u përkasin viktimave të luftës në Kosovë. "Deri më tani ka dy identifikime të reja, për të cilat jemi në komunikim me familjet e personave të identifikuar", ka thënë Kurti përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se varreza masive në Kizhevak të Serbisë ndërlidhet me varrezën masive në Rudnicë. "Ne presim që edhe personat e tjerë, viktimat nga masakra e Rezallës, e që janë në listën e personave të pagjetur, të gjenden në Kizhevak", ka deklaruar Kurti, derisa përkujtoi masakrat e Kralanit dhe të Rezallës në 22-vjetorin e tyre. Gërmimet në varrezën masive të Kizhevakut, pranë Rashkës, janë bërë në fund të vitit të kaluar. Atje janë gjetur mbetjet mortore të 4-5 personave.

Atëbotë autoritetet kanë thënë se kërkimet në Kizhevak do të vazhdojnë në vitin 2021, pasi të përmirësohen kushtet e motit. "Është shumë me rëndësi që gërmimet të rifillojnë në këtë lokacion dhe në lokacionet e tjera të mundshme të varrezave masive", ka thënë të hënën Kurti.

Ai ka thënë se qeveria mbetet e përkushtuar që ta vazhdojë punën duke i dhënë prioritet ndriçimit të fatit dhe vendndodhjes së të pagjeturve, trajtimit më të mirë ligjor dhe institucional të familjeve të tyre dhe të punojmë për vendosjen e drejtësisë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në vitin 1999, rreth 6 500 persona kanë qenë të zhdukur. Që nga ajo kohë janë kryer disa zhvarrime në varreza masive në Kosovë dhe Serbi dhe deri më tash janë gjetur rreth 70 për qind e të zhdukurve. Sipas autoriteteve në Kosovë, të pagjetur vazhdojnë të jenë edhe rreth 1 600 persona, kryesisht shqiptarë.

Protestë kundër gjuhës denigruese të deputetit Ardian Kastrati

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 PRILL - Aktivistë të shoqërisë civile protestuan të hënën në Prishtinë kundër, siç thanë, gjuhës seksiste të profesorit të Universitetit të Prishtinës, Ardian Kastrati, njëherësh deputet i Partisë Demokratike të Kosovës. Një ditë më herët Kastrati bëri një postim në "Facebook", duke përshkruar fizikun e një gruaje të shëndoshë, për të cilin tha se është satirë e shkrimtarit Faik Konica.

Shkrimi, që më pas u fshi nga ia, u konsiderua si ofendim ndaj presidentes së porsazgjedhur të Kosovës, Vjosa Osmani.

Ndonëse Kastrati tha se nuk ka pasur qëllim ofendimin e askujt, protestuesit kërkuan përjashtimin e tij nga Universiteti i Prishtinës. "Kjo gjuhë, e cila prodhon gjuhë të urrejtjes, është një ndër shkaktarët kryesorë të nënshtrimit të grave, dhunës dhe vrasjes së tyre. E, kur kjo bëhet nga personat publikë, e aq më shumë personat universitarë, kjo gjë është e patolerueshme dhe duhet të dënohet", tha aktivistja Liridona Sijarina.

Reagime kundër Kastratit ka pasur edhe në mediat sociale.

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" tha se distancohet nga deklarata individuale e Ardian Kastratit, profesor asistent në Fakultetin Filozofik të UP-së.

Përmes një komunikate për media Universiteti i Prishtinës tha se e dënon fuqishëm gjuhën e përdorur denigruese dhe se do ta trajtojë rastin në fjalë në përputhje me ligjet në fuqi. "UP-ja njofton opinionin që, si institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend, kërkon nga personeli i tij që, pavarësisht institucionit ku janë të angazhuar, me sjelljet, qëndrimet dhe deklaratat e tyre, të ruajnë imazhin e UP-së", thuhet në komunikatë.

Kuvendi i Kosovës votoi të dielën për zgjedhjen e Vjosa Osmanit presidente, me mandat pesëvjeçar. Në seancë nuk morën pjesë deputetët e partisë së Kastratit e as ata të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Listës Serbe.

Osmani është gruaja e dytë që zgjidhet në krye të shtetit, pas Atifete Jahjagës.

Haradinaj: Osmani është presidente e Kurtit

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se me zgjedhjen e Vjosa Osmanit në postin e presidentit, vendi është futur në monizëm, derisa ka shtuar se Osmani është presidente e kryeministrit Albin Kurti. "E gjithë kjo është një tregues që për Kosovën nuk priten ato ditë të mira që i kanë premtuar, sepse kemi të bëjmë me një mashtrim dhe me një sistem që është i një partie. President, kryeministër, kryeparlamentar, kryetar partie është një njeri, është Albin Kurti, në një mënyrë ne po kthehemi në monizëm", ka thënë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Ai ka shtuar se mënyra sesi pozita siguroi kuorumin "dëshmon se vendin nuk e presin ditë të mira". "Dje u vërtetua që fituesit e rinj të zgjedhjeve kanë mungesë guximi që të veprojnë si e parasheh demokracia. Po ashtu, u treguan të zotë dhe treguan se kanë prirje për kontrabandim të votës. Ajo që ka ndodhur nuk është në nderin e Kosovës dhe demokracisë sonë. Pra u zgjodh presidentja me kontrabandim të votave, me deputetë që për përfitime të atypëratyshme, tjetërsuan vullnetin e votuesve të tyre", ka potencuar Haradinaj.

Në 22-vjetorin e masakrës së Rezallës, kërkohet drejtësi për të rënët dhe të zhdukurit

Të hënën u bënë 22 vjet prej që kryer masakra në Rezallë, në të cilin fshat të Skenderajt ushtria dhe policia serbe ekzekutuan 98 shqiptarë, banorë të Rezallës dhe fshatrave përreth, nga të cilët 44 ishin të zhdukur. Më 5 prill të vitit 1999 serbët rrethuan shtëpitë e këtyre familjeve dhe pushkatuan pothuajse të gjithë, kryesisht burra e djem të rinj. Nga masakra e Rezallës vetëm tre persona kanë shpëtuar të gjallë. Përfaqësues të institucioneve kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial të Varrezave në fshatin Rezallë, duke theksuar se nuk ka paqe derisa Serbia t'i pranojë krimet që ka bërë dhe ta njohë pavarësinë e Kosovës

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

SKENDERAJ, 5 PRILL - Në 22-vjetorin e masakrës së Rezallës, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, asamblistë, doktorin e mjekësisë ligjore, Arsim Gërxhaliu, familjarë të dëshmorëve dhe martirëve, kanë bërë homazhe dhe vendosur lule te varret e 98 të rënëve në Kompleksin Memorial të Varrezave në fshatin Rezallë. Me këtë rast, Jashari ka deklaruar se masakra e Rezallës është shembull i sakrificës dhe dëshmi se pa sakrificë e gjak nuk ka liri. "Masakra e Rezallës, po ashtu, është dëshmi e krimeve dhe gjenocidit që kriminelët serbë bënë në Kosovë, duke mos kursyer askënd që fliste shqip e që mbronte pragun e shtëpisë. Fatkeqësisht, familjarët e disa prej martirëve të rënë në masakrën e Rezallës, përpos dhimbjes për humbjen e më të dashurve të tyre, ata kanë jetuar tash e 22 vjet duke pritur gjetjen e trupave të martirëve të kësaj masakre", ka thënë Jashari, duke shtuar se në vazhdimësi si kryetar komune është duke u angazhuar për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka përkujtuar 22-vjetorin e masakrës së Rezallës. Ajo ka thënë se në Rezallë, më 5 prill të vitit 1999, forcat e regjimit gjenocidal të Serbisë rrethuan shtëpitë e fshatit, ndanë nga gratë, nënat e motrat, 98 djem e burra dhe i ekzekutuan mizorisht. "44 nga këta civilë të vrarë ishin të pagjetur. Disa vjet më pas një pjesë e trupave u gjetën në Rudnicë të Rashkës. Tre të mbijetuarit dhe trupat e të vrarëve të gjetur në varreza masive në Serbi ishin dëshmi e fuqishme e krimeve makabre të kryera nga regjimi serb. 22 vjet pas, nevoja për drejtësi riaktualizohet, duke u bërë përpjekje e vazhdueshme e institucioneve të vendit. Ne nuk do të ndalemi së kërkuari vendosjen e drejtësisë për njerëzit tanë sepse ata u privuan nga jeta vetëm pse ishin shqiptarë. Liria dhe paqja kanë kuptim vetëm kur përgjegjësit dhe ekzekutuesit të vihen para drejtësisë. Masakra e Rezallës është dhimbje e jona e vazhdueshme, kujtesë historike dhe sakrifica për lirinë e vendit! Qoftë i përhershëm kujtimi për 98 të vrarët në masakrën e Rezallës!", ka shkruar Osmani.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, gjatë homazheve në Rezallë të Skenderajt ka thënë se nuk ka paqe derisa Serbia t'i pranojë krimet që ka bërë dhe ta njohë pavarësinë e Kosovës. "Sot bashkë me kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, jemi këtu në Rezallë për të nderuar dhe për t'u përkulur para sakrificës dhe rënies së 98 martirëve të Rezallës. Është obligim i institucioneve shtetërore më e pakta çka mund të bëjmë t'i kujtojmë e t'i nderojmë të rënët, sepse falë sakrificës dhe gjakut të derdhur të tyre liria jonë ka qenë e mundshme", ka thënë Konjufca.

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka përkujtuar masakrën e Rezallës. Në 22-vjetorin e kësaj masakre ai ka vlerësuar se, krahas nderimit për të vrarët në masakrën e Rezallës, duhet t'i kujtojmë me nderim edhe rrëfimet tragjike të të mbijetuarve. Për çdo ditë përkujtojmë masakrat e para 22 vjetëve. "Dje u mbushën 22 vjet nga masakra e Kralanit, kurse sot 22 vjet nga masakra e Rezallës. Në masakrën e Kralanit u vranë 87 shqiptarë që ishin qytetarë të komunës së Klinës, Malishevës, Gjakovës dhe Skenderajt. Nga kjo masakër janë më shumë se 40 të zhdukur, vendndodhja e të cilëve ende nuk dihet. Ndërkaq, nga masakra e Rezallës kemi 98 viktima, shqiptarë të ekzekutuar, banorë të këtij fshati dhe të fshatrave përreth. Rezalla nga lufta e fundit kishte 44 të zhdukur, nga të cilët dy viktima janë gjetur në ditët e para të pasluftës në Rrezallë dhe 29 viktima të tjera janë gjetur në varrezën masive Gurorja në Rudnicë të Rashkës. Rezallës i mungojnë edhe 10 persona të zhdukur gjatë luftës së fundit. Më 5 prill të vitit 1999 serbët rrethuan shtëpitë e këtyre familjeve dhe pushkatuan pothuajse të gjithë burrat dhe djemtë e rinj. Nga masakra e Rezallës vetëm tre kanë shpëtuar të gjallë. Nuk mund të kemi paqe pa i pranuar Serbia këto krime dhe pa e pranuar pavarësinë e Kosovës. Lavdi këtyre martirëve! Lavdi këtyre dëshmorëve!", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Masakrën e Rezallës e ka përkujtuar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Njëzet e dy vjet më pas kujtojmë jetët e pafajshme që barbarët i rrëmbyen në Rezallë të Drenicës dhe në Llovcë të Gjilanit. Jemi ende në kërkim të të pagjeturve që janë plagë e hapur e shoqërisë. Ata i japin më shumë zë thirrjes sonë për drejtësi. Përulem para sakrificës, përjetësisht", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook"

Deputetët e PDK-së shkojnë në Rezallë nderojnë 98 martirët e kombit

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, së bashku me deputetë të kësaj partie kanë shkuar në Rezallë për t'i kujtuar e nderuar 98 martirët e kombit që u vranë në prag të shtëpisë nga policia dhe ushtria serbe më 5 prill të vitit 1999. Ai ka thënë se masakra e Rezallës është dëshmi e pastër mbi regjimin serb, që mbështetej në gjenocid dhe mbështeste gjenocidin ndaj popullit civil shqiptar. "Atë çfarë regjimi serb nuk mund ta bënte ndaj UÇK-së, e kërkonte si shpagim ndaj civilëve të paarmatosur, pleqve, grave dhe fëmijëve, ngjashëm siç na tregon historia e kësaj masakre. Si kudo nëpër Kosovë, ndaj këtyre martirëve u bë edhe krimi i dyfishtë përmes zhdukjes së trupave, që bashkë me ta të zhduken edhe dëshmitë. Kjo ka qenë barra dhe agonia e vazhdueshme përgjatë këtyre 22 vjetëve për familjet, për shtetin dhe të gjithë shoqërinë tonë", ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se nuk do ta harrojnë dhe nuk kanë për të harruar kurrë derisa drejtësia ta vë para përgjegjësisë edhe kriminelin e fundit që është përgjegjës për këtë masakër.

Pas mbylljes dyjavore, bizneset është dashur të përkrahen financiarisht

"Ky vendim i shpejtë për mbyllje dy javë është i dëmshëm për bizneset. Qeveria është dashur të bëjë analiza për efektet dhe kundërefektet për gastronominë. Paraprakisht është dashur që të ketë një përkrahje financiare dhe pastaj të merret vendim për mbyllje. Vendimet e tilla që janë marrë më herët e kanë dëmtuar shumë biznesin", ka thënë kryetari i Bordit i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skënder Krasniqi

PRISHTINË, 5 PRILL - Mbyllja dyjavore për disa sektorë të bizneseve dhe pa ndonjë plan për përkrahje financiare të bizneseve ka ngritur shqetësime te komuniteti i biznesit në Kosovë.

Kryetari i Bordit i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skënder Krasniqi, ka thënë se bizneset do të dëmtohen rëndë nga kjo mbyllje, duke theksuar se pasojat do të jenë të rënda për ekonominë. Krasniqi ka thënë se qeveria para se ta merrte një vendim të tillë është dashur të bëjë analiza për efektet dhe kundërefektet që do të vijnë nga ky vendim. "Ne si Odë e Afarizmit e Kosovës vazhdimisht kemi kërkuar që asnjë masë të mos merret pa asnjë përkrahje dhe plan paraprak, pra pa përkrahje financiare të bizneseve. Para se të merret një vendim është dashur të analizohet përkrahja, të njoftohen bizneset për përkrahjen që do të marrin në rast të vendimit për mbyllje", ka deklaruar Krasniqi.

Krasniqi ka treguar edhe hapat që është dashur të marrë qeveria para se ta merrte vendimin për mbyllje. "Ky vendim i shpejtë për mbyllje dy javë është i dëmshëm për bizneset. Qeveria është dashur të bëjë analiza për efektet dhe kundërefektet për gastronominë. Paraprakisht është dashur që të ketë një përkrahje financiare dhe pastaj të merret vendim për mbyllje. Vendimet e tilla që janë marrë më herët e kanë dëmtuar shumë biznesin. Më herët është planifikuar përkrahje financiare për punëtorët në vlerë 170 euro dhe ato 170 euro kanë qenë në ekstrem të vogla. Pra, këto pagesa janë bërë me muaj e muaj vonesë dhe e kanë dëmtuar ekstrem shumë biznesin. Një gjë e tillë nuk do të duhet të përsëritet. Paraprakisht është dashur të bëhet një plan, pra ku do të duhej të bëhej etiketimi i bizneseve, numri i bizneseve, planifikimi i përkrahjes financiare, ndarja e buxhetit dhe alokimi i ndarjeve për buxhetin dhe pastaj mbyllja", është shprehur Krasniqi.

Ai ka thënë se nuk është kundër vendimeve të cilat janë me interesa nacionale. Krasniqi ka radhitur pasojat që mund të jenë katastrofale për bizneset dhe ekonominë e vendit. "Ne si biznese dhe si odë nuk jemi kundër vendimit që është në interes nacional, sikurse që është në këtë rast me pandeminë. Është dashur të veprohet siç po veprojnë vendet e tjera në përkrahje financiare për bizneset. Në rast se vazhdohet me politikat e njëjtat siç ka qenë deri më tash atëherë do të kemi një tragjedi ekonomike në vend, që nënkupton edhe me gjendje të rëndë ekonomike. Dhe në këtë drejtim do të rritet papunësia", ka deklaruar Krasniqi.

Një muaj paraburgim ndaj tre personave që dyshohen për falsifikim të parave

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Gjykata Themelore në Prizren ka caktuar masën e paraburgimit të të miturve L. Sh dhe E. M. pasi dyshohen se kanë kryer veprën penale falsifikim i parasë. Kjo gjykatë masë të njëjtë i ka caktuar edhe G. M për veprën falsifikim i parasë.

Të miturit më 4 prill kishin marrë një pako të dërguar nga O.K nga Turqia ku ishin të vendosura kartëmonedhat false në shumën prej 3750 000 eurosh. Policia ka kryer kontroll të shtëpisë tek i mituri E. M dhe G. M. ku janë gjetur kartëmonedhat. "Gjyqtarja e procedurës në Departamentin për të Mitur ka vlerësuar se të miturit e L. Sh. dhe E.M. dyshohet se kanë kryer veprën penale me peshë shumë të rëndë, shuma shumë e madhe e parave të falsifikuara që të miturit së bashku me personin madhor, të pandehurin G. M., planifikonin ta vënin në qarkullim, andaj gjyqtarja e procedurës ka ardhur në përfundim se caktimi i masës së paraburgimit në këtë fazë është i bazuar me ligj dhe i arsyeshëm dhe se do ta sigurojë zhvillimin e papenguar të rrjedhës së procedurës hetimore-përgatitore dhe sigurimin e pranisë së të miturve në këtë procedurë", thuhet në njoftimin e gjykatës.



Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Përballje interesante në çerekfinale të Ligës Unike

Prishtinë, 5 prill - Sot (e martë) dhe nesër (e mërkurë) do të zhvillohen ndeshjet në çerekfinale të Ligës Unike. Sipas shortit, në çerekfinale do të jenë dy duele në mes të skuadrave nga Kosova dhe Shqipëria, një duel mes skuadrave të Kosovës dhe një mes atyre shqiptare. Takimi i parë do të jetë në mes të Vllaznisë nga Shkodra dhe Pejës. Këto dy skuadra janë ballafaquar më herët edhe në Ligën Ballkanike, andaj pritet një përballje interesante. Më pas është hapja solemne, ku do të ketë mysafirë specialë. Përballja e dytë është ndërmjet Rahovecit dhe Teutës, ku "Vreshtarët" në shtëpi synojnë kualifikimin në gjysmëfinale, ndërsa durrësakët për të dëshmuar se nuk kanë ardhur me flamur të bardhë.

Të mërkurën do të përballen Goga Basket dhe Tirana.

Skuadra nga Durrësi kishte fituar titullin më 2019, kurse tiranasit kanë fituar 46 trofe në histori të klubit dhe sigurisht se do të mundohen të shtojnë edhe një trofe në sirtar. Dueli i fundit çerekfinal është mes finalistëve të Kupës së Kosovës, Golden Eagle Yllit dhe Prishtinës. Skuadra prishtinase triumfoi në Kupë, ndërsa është skuadra më e trofeshme në vend, madje duke fituar dy herë Ligën Ballkanike, por sigurisht do të bëjë çmos që të fitojë edhe këtë trofe të çmuar.

Në anën tjetër, Ylli ka bërë investime, por nuk ka fituar

trofe, andaj triumfi në Ligën Unike do të ishte special për klubin nga Theranda. Garat do të zhvillohen në format të "Final 8" me sistem eliminimi dhe ndeshjet e para çerekfinale do të luhen në Rahovec më 6 dhe 7 prill 2021, ndërsa ndeshjet gjysmëfinale, gara për vendin e tretë dhe finalja e madhe e Ligës Unike, do të zhvillohen më 13-14 prill në Durrës. Ndeshjet në Rahovec do të zhvillohen me masa të rrepta anti-Covid-19, duke iu përmbajtur Udhëzuesit për Rikthimin në Fushat e Basketbollit.

ORARI

Të martë takohen:
16:00 Vllaznia-Peja
19:00 Rahoveci-Teuta

Të mërkurën takohen:
16:00 Goga Basket-Tirana
19:00 Sigal Prishtina-Golden Eagle Ylli

Gjysmëfinalet dhe finalet

13 Prill
16:00 Gjysmëfinalja e parë
19:00 Gjysmëfinalja e dytë

14 Prill
16:00 Ndeshja për vendin e tretë
19:00 Finalja e madhe

Sonte përballjet Real - Liverpool dhe City - Dortmund

Madrid, 5 prill (ER) - Dy nga skuadrat më të suksesshme në historinë e Ligës së Kampionëve, Real Madridi dhe Liverpooli, do të përballen sonte (e martë) në kryeqytetin spanjoll në kuadër të çerekfinales. Reali që është kampion i kësaj gare plot 13 herë do të kërkojë të sigurojë një avantazh në stadiumin "Alfredo Di Stefano" përpara ndeshjes së kthimit që zhvillohet më 14 prill në "Anfield". Pavarësisht se skuadra e drejtuar nga Zinedine Zidane nuk është llogaritur në fillim të këtij edicioni si skuadër favorite, ka arritur të kualifikohet deri në çerekfinale dhe eliminimi i saj gjithmonë është i vështirë në këtë garë.

"Los Blancos" e eliminoi nga rrethi i 16-të më të mirëve skuadrën e Atalantës me rezultat të përgjithshëm 4-1.

Madridi, edhe pse nuk ka qenë në formën më të mirë në këtë edicion, ka fituar nëntë nga njëmbëdhjetë ndeshjet e fundit në të gjitha garat, përfshirë edhe fitoren e së shtunës kundër Eibarit (2-0) dhe tash është vetëm tri pikë pas Atletico Madridit në La Liga. Reali në fundjavë do të përballet me Barcelonën para ndeshjes kthyese me Liverpoolin më 14 prill. "E dimë se mund të zgjasë më shumë se 180 minuta, por ne do të përqendrohemi fillimisht te ndeshja e djeshme. Nuk shohim më tej. Kemi folur shumë për Hazardin. Ai duhet të jetë i qetë. E rëndësishme është të shërohet. Le t'i bëjë gjërat me kujdes dhe të shohim çfarë do të ndodhë", ka thënë Zinedine Zidane.

Ndërsa skuadra e drejtuar nga Jurgen Kloppi bëri një nga paraqitjet më të mira si mysafire të shtunën kundër Arsenalit, ku arriti fitore me rezultat 0-3. "Reds" është në vendin e pestë me vetëm dy pikë larg katër të parëve. Në çerekfinale, Liverpooli u kualifikua pasi e mposhti RB Leipzigun me

rezultat të përgjithshëm 4-0. Klubi anglez ka pasur një sezon zhgënjyes për faktin se nuk arriti ta nisë në mënyrë të duhur mbrojtjen e titullit në Premierë Ligë, por tash synim e ka një vend në mesin e katër klubeve më të mira në Angli dhe triumfin në Ligën e Kampionëve. Mungesat e Realit janë pa kapitenin Sergio Ramos, Dani Carvajal dhe Federico Valverde, kurse "Reds" është pa Jordan Hendersonin, Joel Matipin, Joe Gomezin dhe Virgil Van Dijkun. Sonte (e martë) nga ora 21:00 zhvillohet edhe përballja në mes të Manchester Cityt dhe Borussia Dortmundit.

Sot (e martë) takohen:

21:00 Manchester City - Borussia Dortmund
21:00 Real Madrid - Liverpool

Gjilani deklasoi Besën

Gjilan, 5 prill - Skuadra e Gjilanit ka shënuar fitore me rezultat të thellë ndaj Besës së Pejës (5-1). Skuadra pejane edhe në këtë ndeshje nuk tregoi potencial për t'u përballur me klubet e Superligës. Në minutën e 28 Cyrbja e hapi serinë e golave për vendasit. Pesë minuta më vonë Besa u rikthye në lojë me golin e Tahirit që e shënoi nga penalltia, por kjo ishte e tëra që e arriti në këtë ndeshje. Useini në fund të pjesës së parë e kaloi Gjilanin sërish në epërsi (2-1). Në pjesën e dytë skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi realizoi edhe tre gola të tjerë me anë të Prognit, Hilës (nga penalltia) dhe Rezakut. Pas javës së 24-t, Gjilani zë vendin e katërt me 40 pikë, kurse Besa është e fundit me 10 pikë.

Munishi: Challandesi po bën filma këtu

Prishtinë, 5 prill - Mirlind Daku nuk u ftua nga trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, për ndeshjet e Kosovës kundër Suedisë dhe Spanjës. Lojtari i cili luan te Ballkani është golashënuesi më i mirë në Superligën e Kosovës, por nuk u pa si i nevojshëm nga trajneri zviceran për ta mbajtur repartin e sulmit.

Trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi, ka përkrahur sulmuesin 22-vjeçar në deklaratën e tij, duke kritikuar Challandesin për zgjedhjen e gabuar. Sipas tij, është e pamundur që një lojtar që ka shënuar 26 gola në Superligën e Kosovës të mos thirret për ndeshjet e përfaqësueses.

Edhe Leart Paqarada u ndie i pavlerësuar nga Challandesi duke u shprehur se nuk do të vijë më te Kosova deri në momentin që do të jetë i njëjti trajner. "Një futbollist që shënon 26 gola nuk ftohet dhe vjen dikush tjetër që për sy të ballit nuk luan dot as në Superligën e Kosovës. Është tmerr. Atij zvicerani duhet t'i dhembë koka që vjen dhe bën filma këtu", ka thënë Munishi.

Guardiola: UEFA dhe FIFA po i 'vrasin' futbollistët

MANCHESTER, 5 PRILL - Trajneri Pep Guardiola ka shprehur të gjithë pakënaqësinë e tij ndaj UEFA-s dhe FIFA-s përgjegjëse, sipas tij, për një kalendar rraskapitës të klubeve, plot angazhime, i cili ndikon shumë në gjendjen dhe performancën e lojtarëve. "Futbollistët janë qenie njerëzore, nuk janë makina. Unë i njoh lojtarët, disa prej tyre janë gjithmonë të zemëruar, sepse nuk mund të luajnë çdo ditë. Kjo nuk është e mundur. Të garosh në të gjitha garat këtë sezon pa spektatorë është e vështirë. Nëse nuk bën rotacione në formacion nuk mund të garosh në të gjitha garat. Nëse nuk do ta bënim këtë, ne nuk do të ishim në pozicionin aktual", ka thënë Guardiola.

Manchester City, dominues në Premierë Ligë, është ende në garë për trofe në të gjitha frontet: Champions, "FA Cup" dhe "Carabao Cup": "Djemtë e mi mund të luanin sepse kanë një mentalitet të pabesueshëm, por kanë nevojë për pushim. UEFA dhe FIFA i kanë vrarë lojtarët sepse kjo është vërtet shumë. Ne nuk kemi pasur një pushim të vetëm mesjave që kur kemi filluar sezonin, as edhe një. Kush mund t'i qëndrojë gjithë kësaj ngarkese, jo vetëm fizikisht, por edhe mendërisht, për të qenë gati çdo ditë në ndeshje kundër kundërshtarëve, për t'i fituar ato?! Është e pamundur. Kur bëj rotacion dhe fitoj, unë jam një gjeni dhe njerëzit thonë 'bravo Pep'. Kur humbasim, njerëzit pyesin 'po pse e ndryshoi formacionin?'", ka shtuar Guardiola.

Alioski: Duam ta mposhtim sërish Gjermaninë

Tiranë, 5 prill - Futbollisti me origjinë shqiptare foli për suksesin historik ndaj Gjermanisë dhe paraqitjet në kampionatin anglez, ku ka për trajner një "të çmendur" si Marselo Bielsa. Anësori i Leeds Unitedit dhe përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut, Ezgjan Alioski, ishte një nga të ftuarit e emisionit "Zona Gol" në ekranin e Supersport.

Na fol pak për atë fitore historike të Maqedonisë së Veriut ndaj Gjermanisë.

Alioski: Shkuam me shumë dëshirë sepse e dinim që nuk kishim gjë për të humbur dhe ishte mundësia të tregonim cilësinë tonë. Luajtëm shumë mirë taktikisht dhe është një fitore që do të mbahet mend gjatë. Asnjë përfaqësuese ballkanike nuk ka fituar në Gjermani. Skuadrën katër herë kampione të botës vjen Maqedonia e vogël dhe e mposht. Duhet ta shijojmë dhe besoj se do mbahet mend gjithmonë, por për të shkuar në botëror na duhet ta mposhtim sërish Gjermaninë në shtëpinë tonë.

Cili është çelësi i suksesit të Maqedonisë së Veriut?

Alioski: Kemi individualitete me shumë cilësi, kemi shumë talente. 11-shja titullare përgjithësisht luan jashtë Maqedonisë dhe kjo besoj na ka ndihmuar edhe me shumë. Organizimi ka qenë jashtëzakonisht i mirë, fillon nga sistemi i moshave e deri te kombëtarja A. Ka nisur gjithçka nga presidenti Sejdini, më pas trajneri, lojtarët. Kemi shumë vetëbesim, pasi kemi 5-6 vjet së bashku dhe nuk jemi thjesht kolegë, jemi vërtet miq me njëri-tjetrin, kemi një grup të bashkuar.

Keni filluar të mendoni për Kampionatin Evropian?

Alioski: Është ende herët për ta ndier aromën e Evropianit, por mendoj se kur të vijë momenti do të kemi shumë emocione, të gjithë, madje edhe Pandev që ka fituar Champions Leaguen. Do të jetë një ndjenjë e papërjetuar më parë, por do të shkojmë me shumë dëshirë sepse kjo është pjesëmarrja e parë dhe nuk i dihet kur mund të jetë pjesëmarrja e radhës në Evropian për Maqedoninë e Veriut. Duhet ta shijojmë.

Si po shkon përvoja me Leeds Unitedin në Premierë Ligë?

Alioski: E them me siguri qe Bielsa më ka bërë një lojtar shumë më të fortë. Më ka përmirësuar jo vetëm në fushë, por edhe nga ana psikologjike, sepse falë tij jam rritur shumë. Në skuadër nuk kemi një yll me emër të madh, por jemi një ekip që punojmë shumë, kemi disa vite së bashku dhe funksionojmë si grup. Nëse ky do të ishte viti ynë i dytë në Premierë me Bielsën në stol, ndoshta do të luftonim për një vend në Champions.

Si është të punosh me Bielsën?

Alioski: Bielsa është një njeri shumë i veçantë. Nuk ka dëshirë te ketë kontakte me lojtarët, por është një trajner që të motivon shumë, çdo ditë në stërvitje mëson diçka të re nga ai. Është një njeri që kontrollon gjithçka, nga ushqimi e deri tek ushtrimi i fundit në stërvitje. Është rigoroz dhe sa, për shembull, nëse unë nuk bëj 12 km në ndeshje, kam probleme me të. Kur flet me Bielsën nuk është "loco", ashtu si e ka pseudonimin, por fiksimi që ka për punën edhe për gjërat e vogla e bën të jetë unik, nuk ka të dytë. Është trajner fjalë-pak e punë-shumë.

Interesi për gjuhët e ndryshme.

Alioski: Flas shtatë gjuhë sepse jam rritur në Zvicër, aty kam mësuar gjermanisht, italisht dhe anglisht. Spanjishten e kam mësuar këtu në Angli, ndërsa gjuhën maqedonase në kombëtare. Megjithatë, në shtëpi flasim gjithmonë shqip.

SHKURT

Boca Juniorsi synon transferimin e Cavanit dhe Melos

Boca Juniorsi ka vënë nën shënjestër dy lojtarë të mëdhenj për sezonin e ardhshëm, me objektivin për ta fituar Kupën Libertadores, që për ta duket e "mallkuar". Sipas mediave argjentinase, në krye të listës së merkatos së "Xeneizes" janë Felipe Melo, i cili aktualisht luan te Palmeiras dhe Edinson Cavani, të cilit i skadon kontrata në fund të sezonit me Manchester Unitedin dhe për momentin nuk ka vendosur nëse do të rinovojë ose jo me "djajtë e kuq".

Florenzi rezulton pozitiv me Covid-19

Pas Marco Verratit, edhe bashkëlojtari i skuadrës, Alessandro Florenzi, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Alessandro Florenzi ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Florenzi është lojtari i dytë i PSG-së që rezulton pozitiv me virus. Para tij pozitiv ishte edhe Marco Verratti. Të dy lojtarët ishin në detyrë me Kombëtaren italiane. Kjo gjë shton frikën që lojtarët italianë që luajnë në Evropë mund ta kenë marrë Covid-19 nga Kombëtarja. Florenzi është në izolim dhe duke iu përmbajtur rregullave anti-Covid-19.

Ibra, afër rinovimit të kontratës me Milanin

Sulmuesi i Milanit, Zlatan Ibrahimoviq, është shumë pranë rinovimit me kuqezinjtë. Gjiganti suedez ka qenë në bisedime e sipër me drejtuesit e klubit javët e fundit dhe, mesa duket, gjithçka ka shkuar mirë për të dyja palët. Sipas raportimit të "Tuttomercatoweb", tashmë është vetëm çështje kohe zyrtarizimi i rinovimit të kontratës, pasi marrëveshja është arritur. Kështu, 39-vjeçari do ta firmosë kontratën e re e cila do të përfundojë në qershorin e vitit 2022. Kanë mbetur vetëm detajet përfundimtare që lidhen me bonuset e objektivat sezonalë, por që nuk priten të krijojnë probleme. Drejtuesit e "Djallit" i besojnë ende Ibrës dhe kërkojnë vazhdimin e projektit të nisur me të në krye, pasi me shumë mundësi ata do të rikthehen edhe në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm.

Di Maria: Messin e pres në PSG

Angel Di Maria është një nga lojtarët më të rëndësishëm të Paris Saint Germainit. Argjentinasi ishte në fund të kontratës me klubin, por Leonardo nuk vonoi ta bindte për ta zgjatur kontratën dhe vetë lojtari e pranon që nuk mund të ikte nga kampionët e Francës. "Unë jam i lumtur këtu bashkë me familjen dhe ajo ndihet shumë mirë dhe kjo për mua ka shumë rëndësi. Kjo ishte një nga arsyet që unë pranova të rinovoja pasi nuk mund të largohesha nga një ambient fantastik dhe e dyta për arsye sportive. Këtu po bëjmë shumë mirë dhe ëndrra ime është ta fitoj Ligën e Kampionëve", ka thënë Di Maria. "Të kesh një lojtar si Lionel në skuadër është fantastike, e mrekullueshme. Nuk mund të flas më shumë sepse ai tani është lojtar i Barcelonës dhe ka një kontratë, por të shikojmë se çfarë do të ndodhë në verë lidhur me këtë situatë", ka shtuar Di Maria.

Përfundon sezoni për Martialin

Manchester Unitedi nuk do të mund të llogarisë në sulmuesin e vet, Anthony Martial, për pjesën e mbetur të sezonit për shkak të lëndimit që e pësoi ai në një ndeshje me Kombëtaren e Francës, ka konfirmuar trajneri Ole Gunnar Solskjaer. Martial, 25-vjeçar, u paraqit për Francën kundër Ukrainës dhe Kazakistanit javën e kaluar, para se të pësonte lëndim në gju. "Ta humbasësh Anthonyn për pjesën e mbetur të sezonit është shumë zhgënjyese. Nga Franca na patën thënë se nuk ishte serioze, por duket keq tani", ka thënë Solskjaer. Martial i ka shënuar shtatë gola për Unitedin në përgjithësi këtë sezon, por vetëm tri në 19 ndeshje në vitin 2021. Unitedi nuk do të mund të llogarisë as në mbrojtësin Eric Bailly në ndeshjet e ardhshme, i cili është infektuar me koronavirus. Skuadra e Solskjaerit do të përballet me Granadan në çerekfinale të Ligës së Evropës në dy të enjtet e ardhshme, si dhe me Tottenhamin të dielën.



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re,* pastaj në revistën *Zëri.* Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.
Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

ISBN 978-9951-780-10-0

4 99 €

NJË PALË KËPUCË NË BERLIN • Daut Dauti

Daut Dauti

NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë

ARMAGEDONI

Rrallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymber Kelmendi

***

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

***

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve te shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

***

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

***

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ISBN 978-9951-780-37-7

ÇMIMI: 5.99 €

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI

ARMAGEDONI

AGRON SHALA

DEKALOGU

「nga Moisiu deri te Kieślowski」

Duke u bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, operatori i kompanisë "Gentipharm" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e barnave farmaceutike, Korroticë e Epërme, Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 26.04.2021, në ora 10:00, në hapësirat e Gentipharm , Komuna e Gllogocit, do të organizohet debat publik nga operatori i kompanisë "Gentipharm" Sh.p.k. fabrikë për prodhimin e barnave farmaceutike, Korroticë e Epërme, Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Produkt D.O.O shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811120708

▶ Florian Kasumi shpall te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMLE "Hasan Prishtina"

▶ Flamur Maliqi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ismail Qemaili"

▶ Benjamin Aruci shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni

▶ Elldin Gjerqeku shpall te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"

▶ P.P "Ina Sped" shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 71171094

▶ Naim Peci shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Skënderbeu"

▶ Sylejman Sadiku shpall te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani"

▶ Eurofly B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 71012034

Ramadan Pllana shpall te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMLE " Hasan Prishtina"

▶ Nexhat Seferi "Auto Taxi" shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810568082

▶ Ahmet Tahiri shpall te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"

▶ Mumin Ferizi shpall te pavlefshme dëftesën e vitit 10 te SHMLM "Dr. Xheladin Deda"

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L